



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes Rrahman Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	
Përmes:	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Murtezani, U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 09.02.2017
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Shtimes	020-279
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Npi.01/26, për refuzimin e kërkesës Nr.01/016/37019.
I miratuar më datë më datë: 01.02.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.02.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje Rrahman Jakupi, predsedavajući Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini Pravno odeljenje i nadgledanje opština, MALS	
Preko:	Mirjana Jevtić, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a	
Od:	Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana: 09.02.2017. 020-279
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Štimlje	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka Npi.01/26 za odbijanje zahteva br.01/016/37019
Usvojena dana: 01.02.2017. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 06.02.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

HYRËSE-ULAZNA-INGOJING			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministritet Lokalne Samoprave / Administratione			
Ministry of Local Government Administration			
Data	06.02.2017		
Datum	06.02.2017		
Data	06.02.2017		
Niveli organizativ	Sk. i Llojit	Shifra	Vlera
-y-	020-278		



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
 Nr.01-60/01-1256/17 datë:23.01.2017



Npi - 01/26 datë: 01.02.2017

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01/016/37019 datë: 15.12.2016, të TV - "Dielli" Media SH.P.K Adresa: Tregtia, Mati I, 10.000 Prishtinë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, përkrahje financiare brenda mundësive, për Projektin e filmit dokumentar "Saga e Reçakut" i cili do të shfaqet me rastin e shënimit të 18 vjetorit të "Masakrës së Reçakut" të cilin merr përsipër që ta realizojë ekipi i filmave dokumentar të TV-"Diellit". Kostoja e filmit kushton 4500 euro. Skenari provizor: Reçaku gjatë historisë, foto të vjetra, personalitete, dokumente, dëshmitarë, kufomat, lufta e UÇK-së, Reçaku sot, etj. Kuvendi i Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS Nr.01/016/37019

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2017, të mbajtur më: 01.02.2017, me shumicën e votave vendosi që kërkesa Nr.01/016/37019, e TV - "Dielli" SH.P.K nga Prishtina të Refuzohet, me arsyetimin se: a/ Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2017 është ndarë më 28.09.2016 për të gjitha kategoritë, b/ Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal me shkresën Nr.020-1513/5 datë:24.11.2016 ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes që të rishikojë vendimin Nr.01/006/32286-294 e datës 31.10.2016 për Televizionin lokal "Spin" në Shtime, me arsyetimin se është në kundërshtim me ligjin e porkurimit publik, dhe ky vendim është anuluar nga Kuvendi. c/ Po ashtu Kuvendi ka marrë sygjërim nga OJQ "Polis" që Kuvendi të ketë parasysh transparencën dhe procedurat ligjore kur bëhet fjalë për ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sidomos për bizneset private.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi i Kuvendit
 Rrahman Jakupi